

**PROGRAMI
I PROVIMIT**

QENDRA SHETËTËRORE E PROVIMEVE

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

MATURË SHETËTËRORE

**ARSIMI GJIMNAZOR
ARSIMI I MEËM PROFESIONAL**

Shkup, 2010

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE

PROGRAMI I PROVIMIT

**GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI**

**TË MATURËS SHTETËRORE
PËR ARSIMIN GJIMNAZOR
DHE SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE**

Programi i provimit të maturës shtetërore nga gjuha shqipe dhe letërsia është miratuar me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 07-123/1 prej vitit 29.01.2010.

1. HYRJE

Gjuha shqipe dhe letërsia është lëndë që mësohet në gjimnaz dhe në arsimin e mesëm profesional gjatë katër viteve shkollore. Kjo lëndë qëllim themelor ka aftësimin e nxënësve për komunikim gojor dhe me shkrim në gjuhën standarde shqipe. Gjuha shqipe dhe letërsia nxënësit i aftëson për lexim analitik dhe kritik të veprave letrare.

Duke u mbështetur në Konceptcionin e maturës dhe të provimit përfundimtar, Provimi i maturës shtetërore nga gjuha shqipe dhe letërsia për qëllim ka:

- ngritjen e cilësisë së arsimit të mesëm;
- përcjelljen dhe kontrollimin e realizimit të programeve mësimore nga gjuha shqipe dhe letërsia (mbështetur në standardet arsimore në nivel shtetëror);
- marrjen e diplomës së arsimit gjimnazor apo profesional (rrumbullakësimin e arsimit të mesëm);
- selektimin për arsimimin universitar (kalim vertikal);
- informimin e nxënësve, prindërve dhe institucioneve të tjera arsimore për sukseset e nxënësve nëpërmjet vlerësimeve (verifikimeve) adekuate.

Në bazë të Konceptcionit, lënda gjuhë shqipe dhe letërsi bën pjesë në lëndët e detyrueshme dhe është pjesë përbërëse e maturës shtetërore.

Programi i provimit të maturës nga gjuha shqipe dhe letërsia mbështetet në programin mësimor të gjuhës shqipe dhe letërsisë që realizohet gjatë katër viteve shkollore. Lëmenjtë e kësaj lënde janë **GJUHA** dhe **LETËRSIA**, ndërsa dituritë e nxënësve do të verifikohen (kontrollohen) përmes aftësive: **Të folurit, Të lexuarit, Letërsi** (zbatimi dhe zotërimi i termeve të teorisë së letërsisë në vepra të njohura e të panjohura letrare) dhe **Të shkruarit**.

Dedikimi, baza dhe përmbajtja e Programit të provimit

Programi i provimit është dokument, i cili u dedikohet nxënësve të arsimit të mesëm në Republikën e Maqedonisë.

Qëllimi themelor i këtij dokumenti është informimi i nxënësve me përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të Provimit të maturës nga gjuha shqipe dhe letërsia.

Programi i provimit të maturës ka këto komponente:

- Qëllimi i provimit
- Përmbajtja e provimit
- Rrjeti i specifikimit
- Konkretizimi i qëllimeve
- Përshkrimi i provimit
- Kriteret e vlerësimit.

2. QËLLIMI I PROVIMIT TË MATURËS

Provimi i maturës nga lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë do të thotë rumbullakësimin (vlerësim përfundimtar) e diturive dhe aftësive të nxënësve që duhet t'i posedojnë në fund të procesit katërvjeçar arsimor.

Qëllimi kryesor i Provimit të maturës nga gjuha shqipe dhe letërsia për arsimin e mesëm është që të bëjë kontrollimin dhe verifikimin e diturive të nxënësve nga lëmenjtë e **gjuhës dhe letërsisë**. Nga lëmi i **gjuhës** do të kontrollohen aftësitë e komunikimit gojor e me shkrim dhe përdorimi i drejtë i gjuhës standarde shqipe, ndërsa nga lëmi i letërsisë aftësitë për qasje kritike dhe analitike të veprave letrare, si dhe të shkruarit e pavarur të një teksti të organizuar nga një lëmë e caktuar.

Për ta dhënë Provimin nxënësi duhet:

- t'i përdorë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme nga lënda gjuhë shqipe dhe letërsi;
- në mënyrë të pavarur të koncipojë dhe të përdorë të shprehurit gojor dhe me shkrim;
- t'i zbatojë rregullat drejtshkrimore dhe rregullat e të folurit të gjuhës standarde shqipe;
- të interpretojë një vepër të caktuar letrare në mënyrë kritike dhe analitike;
- të lexojë tekste të njohura dhe të panjohura dhe të bëjë vlerësime kritike në mënyrë të pavarur.

3. PËRMBAJTJA E PROVIMIT

3.1. GJUHË

Qëllimet:

- zbatimi i normave gjuhësore të gjuhës së sotme standarde shqipe në komunikimin gojor dhe me shkrim.

Nxënësi duhet:

- t'i zbatojë rregullat e drejtshkrimit dhe rregullat e të folurit;
- të sajojë shprehje në mënyrë të pavarur dhe të drejtë;
- të zbatojë gjuhë dhe leksik përkatës në situata të ndryshme.

PËRMBAJTJET

1. SHKENCA MBI GJUHËN - Gjuhë kombëtare - gjuhë dialektore - gjuhë standarde
2. ZHVILLIMI HISTORIK I GJUHËS SHQIPE Vendi i shqipes në grupin e gjuhëve indoevropiane
3. FONETIKË - Rrokja, dallimi i rrokjeve, llojet e fjalëve sipas rrokjeve
4. THEKSI NË GJUHËN SHQIPE - Llojet e fjalëve sipas theksit - Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit
5. DREJTSHKRIMI DHE SHENJAT E PIKËSIMIT NË GJUHËN LETRARE SHQIPE - Përdorimi i shkronjës së madhe - Zbatimi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe - Të shkruarit drejt i shkurtesave
6. MORFOLOGJI - Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe - Kategoritë gramatikore të fjalëve - Funksioni i fjalëve në tekst

7. SINTAKSË - Struktura gramatikore e fjalisë - Rendi i gjymtyrëve në fjali
8. LEKSIKOLOGJI - Tipet themelore të kuptimeve të fjalëve
9. FRAZEOLOGJI - Struktura e frazeologjizmave dhe marrëdhëniet e tyre me pjesët tjera të tekstit
10. STILISTIKË - Llojet e stileve
11. DIALEKTOLOGJI - Dialektet e gjuhës shqipe dhe gjuha e sotme letrare

3. 2. LETËRSI

Qëllimet:

Nxënësi është i aftë për:

- zbatimin e diturive për karakteristikat dhe përfaqësuesit e periudhave të ndryshme të letërsisë kombëtare dhe botërore;
- interpretimin dhe komentimin kritik dhe kreativ të veprave letrare.

Nxënësi duhet:

- t'i qaset veprës letrare në mënyrë analitike-krijuese dhe kritike;
- të përcaktojë kontekstin e veprës letrare (vendin, kohën, zhanrin);
- t'i njohë (dallojë) termet teoriko-letrare;
- të krahasojë dhe të vlerësojë individualisht vepra letrare të letërsisë kombëtare dhe botërore.

LETËRSIA SHQIPTARE

Shkenca e letërsisë	
Teoria e letërsisë - Proza - Poezia (vargu) - Lirika - Epika (vargje; prozë) - Drama (vargje; prozë) - Folklori / miti - legjenda	
Letërsia popullore Lirika familjare dhe shoqërore	
Fillet e letërsisë kombëtare - Dokumentet e para të gjuhës shqipe - Letërsia e vjetër shqiptare 1. Marin Barlet 2. Hasan Zyko Kamberi 3. Muhamet Kyçyku Çami	Buzuku, Budi, Bogdani, Variboba, Bardhi "Historia e Skenderbeut " Poezitë "Paraja "dhe "Trahani" "Erveheja"

Letërsia antike	Homeri - Iliada (kënga VI dhe XXIV)
Humanizmi dhe Renesansa në Evropë 1. Dante Aligieri 2. Miguel de Servantesi 3. Uiliam Shekspiri	Komedia hyjnore - "Ferri" "Don Kishoti" "Hamleti"
Klasicizmi në Evropë 1. Moliere	"Tartufi"
Letërsia e Rilindjes Kombëtare 1. Jeronim de Rada 2. Zef Serembe 3. Anton Santori 4. Naim Frashëri 5. Pashko Vasa 6. Andon Zako Çajupi 7. Asdreni	"Kengët e Milosaos"; "Serafina Topia" "Poezia" "Emira" "Lulet e verës"; "Bagëtëi e bujqësi" "Bardha e Temalit" "Baba Tomorri"; "14 vjeç dhëndër" "Andrra e lot" dhe "Reze dielli"
Romantizmi në Evropë 1. Xhorxh Gordon Bajroni	"Çajld Harold"
LETËRSIA SHQIPE E GJYSMËS SË PARË TË SHEKULLIT XX 1. Gjergj Fishta 2. Faik Konica 3. Fan Noli 4. Lasgush Poradeci 5. Ali Asllani 6. Migjeni 7. Esad Mekuli 8. Sterjo Spasse 9. Mitrush Kuteli	"Lahuta e Malcis" "Doktor Gjilpëra" "Albumi" "Vallja e yjeve"; "Ylli i zemres" "Hanko Halla" "Vargjet e lira" "Për ty" "Nga jeta në jetë", "-Pse?" "Netë shqiptare"
REALIZMI NË EVROPË 1. Honore de Balzaku 2. Dostojevski 3. Sharl Bodleri	"Xha Gorio" "Krimi dhe ndëshkimi" "Lulet e së keqes "

LETËRSIA E PASLUFTËS SË DYTË BOTËRORE 1. Petro Marko 2. Jakov Xoxa 3. Martin Camaj 4. Dritëro Agolli 5. Ismail Kadare 6. Azem Shkreli 7. Adem Gajtani 8. Ali Podrimja	“Hasta la vista” “Lumi i vdekur” “Dranja” “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" “Kronike në gur” “Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut “Sytë e Evës” “As dru as zog -dashuri” “Lum lumi”
LETËRSIA BASHKËKOHORE BOTËRORE 1. Franc Kafka 2. Frederiko Garsia Lorka – 3. Albert Kami	“Procesi” “Romansa e xhandarmërisë spanjolle” “I huaji “

4. KONKRETIZIMI I QËLLIMEVE, DITURIVE DHE AFTËSIVE SIPAS LËMENJVE

4.1. TË SHKRUARIT

QËLLIMET (NXËNËSI MUND)	TEMA DHE SQARIME
1. Të shkruajë tekst me sintaksë të rregullt.	Të rregullohet sipas normave sintaksore teksti me radhitje të përmbysur.
2. Të shkruajë tekst sipas normave gjuhësore	Të përmirësojë gabime gjuhësore dhe drejtshkrimore, ;...të transformojë në gjuhën standarde shqipe tekst të shkruar në dialekt...
3. Të shkruajë tekste me qëllime praktike.	Lutje, letër, plotësim i formularëve të ndryshëm, biografi, deklaratë etj.
4. Të shkruajë hartim me shkrim për një temë të caktuar, duke shfrytëzuar për burime informata të ndryshme	Ekologji, film, muzikë, drogë, ndikimi negativ i mediave, ngjarje nga përditshmëria
5. Të shkruajë komentin për tekstin e lexuar në gjuhën standarde shqipe	Nga proza, poezia dhe drama
6. Të shkruajë mendim personal për një tekst të caktuar	Tekst publicistik
7Të transformojë në gjuhën standarde shqipe një tekst të shkruar në dialekt...	Tekst dialektor

4.2. TË LEXUARIT

QËLLIMET (NXËNËSI MUND):	TEMA DHE SQARIME
1. Ta përcaktojë llojin e tekstit në bazë të temës	- Prezanton fakte të dhëna; - Prezanton mendime; - Argumenton - Jep mendim për pëlqimin e ndonjë argumenti
2. T'i përcaktojë dhe t'i krahasojë stilet e teksteve	- Përcakton dhe krahason stilet e teksteve: administrativ; publicistik; artistik; shkencor dhe gazetaresk
3. T'i dallojë rëndësinë dhe funksionin e shprehjeve frazeologjike prej shprehjeve të tjera	- I kupton (dallon) shprehjet frazeologjike. - Shembull: Ata kanë edhe qumësht dallëndysheje (Janë shumë të pasur). - S'kam parë ditë të bardhë (Kam vuajtur).
4. T'i identifikojë personazhet kryesorë, personalitetet dhe mendimet në tekst	- Identifikon personazhet dhe personalitetet dhe mendimet në tekstin e dhënë.
5. Të përcaktojë lidhjen e elementeve të përmbajtjes me funksionin e tekstit në praktikë	- Dallon dhe lidh temën, personazhet, problemet; motivet; porositë nga teksti me praktikën.
6. Të hetojë dallimin ndërmjet realitetit dhe fiksionit në një tekst të caktuar	- I heton, kupton dhe prezanton ndryshimet në tekst.
7. Të kuptojë rëndësinë dhe rolin e tekstit në të kaluarën dhe të tashmen	- Vlerëson aktualitetin e tekstit për sot në bazë të ngjarjes, gjuhës dhe stilit

4.3. LETËRSI

QËLLIMET (NXËNËSI MUND)	TEMA DHE SQARIME
1. T'i dallojë karakteristikat themelore të një drejtimi letrar në një vepër të caktuar letrare	- Shembull: karakteristikat e romantizmit: kulti ndaj së kaluarës, dashuria ndaj natyrës, ikja nga realiteti dhe udhëtimi në vende të panjohura dhe larg atdheut, pikëllimi botëror...
2. T'i analizojë karakteristikat kryesore të drejtimeve letrare në një tekst të caktuar	Tekste nga: - humanizmi dhe renesansa, romantizmi, klasicizmi, realizmi, ekspresionizmi, simbolizmi, ekzistencializmi
3. Ta përcaktojë kronologjinë e ngjarjeve në një vepër letrare	- Fabula, syzheu, naracioni (linear, paralel etj.) - monologu i brendshëm, dialogu
4. T'i dallojë termet nga teoria e letërsisë në një tekst të njohur dhe të panjohur letrar	- mjetet shprehëse stilistike - gjinitë dhe llojet letrare
5. Ta përcaktojë strukturën e kompozicionit në veprën letrare	- Strofa, soneti, akti, skena, kapitulli
6. Ta përcaktojë kohën dhe vendin e ngjarjes në veprën letrare	- Ngjarja zhvillohet në të kaluarën, në të ardhshmen, në kohë të imagjinuar, në kohë reale dhe në vende të imagjinuara
7. Të analizojë personazhe sipas portretizimit të brendshëm dhe të jashtëm	- atributet e personazheve -- personazhi-personazhe
8. Të përcaktojë temat dhe motivet në një tekst të caktuar letrar	Temat: - dashuria, tradita, identiteti etj.
9. Të dallojë një vepër letrare nga një vepër e llojit tjetër në bazë të stilit dhe gjuhës	- stil shkencor, stil administrativ, kundrejt stilit artistik - arkaizmat, neologjizmat... kundrejt leksikut profesional.

4.4. TË FOLURIT

QËLLIMET (NXËNËSI MUND)	TEMA DHE SQARIME
1. Të bëjë prezantim të organizuar dhe të pavarur për një temë të caktuar.	- Në çdo familje ka konflikte gjeneratash - Ç'është për të rinjtë veshja moderne? - Të drejtat e njeriut dalin nga obligimet e tij
2. Të interpretojë qëndrime dhe argumente në situata të ndryshme	- Situata kur duhet të pajtohet me argumentet e të tjerëve. - Reagon sipas situatës varësisht nga roli që ka
3. Të referojë në mënyrë të pavarur për ndonjë ngjarje.	- Shfaqje teatrale - Ndeshje sportive - Mbledhje - Koncerte - Artikull gazetaresk - Vepër letrare
4. Të zhvillojë diskutim të pavarur për një temë të caktuar.	- Për shembull: "Të drejtat e njeriut dalin nga obligimet e tij" - në rolin e liderit në diskutim: - hyrje në temën për diskutim. - udhëheq me diskutimin - në rolin e pjesëmarrësit - i prezanton qëndrimet dhe argumentet e veta.
5. Të prezantojë në mënyrë të pavarur fakte të hulumtuara për një temë të caktuar.	- Shembull: Jeta e njerëzve para 15 viteve. - mbledh, kërkon - shfrytëzon informata komunikativo- teknologjike - klasifikon - formulon
6. Të prezantojë ide personale dhe zgjidhje për çështje të caktuara	- Situata konfliktuale (nxënës- nxënës; arsimtar - nxënës) - Probleme të nxjerra nga vepra të caktuara - Probleme me të cilat nxënësi ballafaqohet për çdo ditë
7. Të përdorë artikullim dhe intonacion të qartë për një temë të caktuar.	- Në të folurit spontan dhe - në të folurit e përgatitur - duhet të përdorë: - tekst logjik - gjestikulim - pauzë

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

5. PËRSHKRIMI I PROVIMIT

5.1. STRUKTURA E PROVIMIT TË MATURËS

Provimi i maturës nga gjuha shqipe dhe letërsia përbëhet prej tri pjesëve nëpërmjet të cilave vlerësohen katër (4) aftësi. Aftësitë e caktuara kanë proporcion të njëjtë në procesin e vlerësimit.

Aftësia **Të folurit** paraqet pjesë interne të provimit dhe do të zhvillohet në shkollë sipas kriterëve të përcaktuara për realizimin e provimit. Realizimi i provimit të kësaj aftësie duhet të fillojë në fillim të gjysmëvjetorit të dytë të vitit të katërt. Arsimtari i planifikon terminet dhe numrin e kandidatëve (për çdo ditë) që do të japin provimin e maturës. Vlerësimi i diturive dhe aftësive nga **Të folurit** do të bëhet sipas kriterëve përkatëse.

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate.

Aftësitë **Të Lexuarit dhe Letërsia** janë pjesë eksterne e provimit të maturës me numër të barabartë të pikëve. Aftësitë **Të lexuarit dhe Letërsia** janë pjesa e parë e provimit dhe testi do të përmbajë numër të pyetjeve përafërsisht të barabarta për të dyja pjesët. Vlerësimi i testit do të realizohet me anë të çelësit.

Të shkruarit është pjesa e dytë eksterne e provimit të maturës dhe do të vlerësohet sipas kriterëve të veçanta.

Pjesa interne: Të folurit;

Pjesa eksterne: Të lexuarit, Letërsia, Të shkruarit.

Provimi përbëhet prej test - librezës me detyra të provimit nga tri aftësitë e lartpërmendura.

5.2. KOHËZGJATJA E PROVIMIT

Pjesa eksterne: Test - librezat– 240 minuta

Pjesa interne:

Të Folurit - koha e përgatitjes - 15 minuta
- nxënësi flet - 15 minuta

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

5. 3. LLOJI I DETYRAVE TË PROVIMIT

Provimi i maturës nga gjuha shqipe dhe letërsia do të përmbajë detyra të provimit:

- detyra të llojit të hapur;
- detyra me alternativa përgjigjesh;
- me plotësime;
- me nënvizime;
- detyra të llojit të esesë (tekste të shkruara me numër të caktuar të fjalëve).

5. 4. RRJETI I SPECIFIKIMIT

Përmbajtjet programore	Aftësia 1	Aftësia 2	Aftësia 3	Aftësia 4	Gjithsej
	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit	Letërsia (zbatimi dhe vlerësimi i termeve teoriko-letrare)	
GJUHË 50%	20%	5%	20%	5%	50%
LETËRSI 50%	5%	15%	10%	20%	50%
Gjithsej:	25%	20%	30%	25%	100%

6. MËNYRA E VLERËSIMIT

Numri i përgjithshëm i pikëve që mund të fitohet në pjesën eksterne të provimit është në interval prej 80-100.

Përgjigjja e saktë e detyrave me më shumë zgjidhje (në të cilën nxënësi ka mundësi të përcaktohet vetëm për njërën përgjigje) vlerësohet me 1 pikë.

Përgjigjja e saktë në detyrat ku kërkohet përgjigje drejtpërdrejt e shkurtër (me një ose me më shumë fjalë), gjithashtu vlerësohet me 1 pikë.

Detyrat në të cilat kërkohet të paraqitet si zgjidhet ndonjë detyrë (situatë problematike), të diskutohet, të arsyetohet ose të vlerësohet ndonjë zgjidhje ose qëndrim, vlerësohen ashtu që ndaras vlerësohet zgjidhja e saktë në çdo fazë të përgjigjes së kërkesës së detyrës. Varësisht nga numri i kërkesës këto detyra vlerësohen me 2 ose 3 pikë.

Ndarja e pikëve për vlerësimin e detyrave të llojit të esesë bëhet sipas kriterëve eksterne.

Vlerësimi do të bëhet në mënyrë eksterne dhe e centralizuar (në një qendër të caktuar) nga vlerësues të pavarur, në bazë të përgatitjes së udhëzimit paraprak dhe të kriterëve përkatëse.

Përfshihet aftësia e **Të folurit** ku vlerësimin e përgjithshëm të kësaj aftësie e realizojnë vetë arsimtarët në shkollë duke u mbështetur në kriteret e vlerësimit të aftësisë së të **Të folurit**. Vlerësimi realizohet gjatë mbajtjes së provimit prej më së paku 2 arsimtarëve në bazë të kriterëve të vlerësimit të kësaj aftësie.

*** Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate**

Numrin i pikëve për dhënien e provimit nga gjuha shqipe dhe letërsia, si dhe diferencën e pikëve për çdo notë pozitive (prej 2 deri 5) përcaktohet pas zbatimit të provimit.

* Për këtë aftësi është përgatitur dokument i veçantë –Programi i provimit për aftësinë e **Të folurit**

AFTËSITË TË CILAT VLERËSOHEN

Provimi i maturës nga gjuha shqipe dhe letërsia do t'i vlerësojë aftësitë e nxënësit në **Të folurit**, në **Të lexuarit**, në **Letërsi** dhe në **Të shkruarit**

TË FOLURIT

Qëllimi themelor i të **Folurit** është që t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve për organizimin e prezantimit gojor në tema dhe situata të ndryshme.

Forma e provimit: pjesa me gojë e provimit të maturës

Mënyra e realizimit: interne

Format e të shprehurit me gojë: Të folurit (*shpjegim, recitim, koment, raport*), **bisedimi ose dialogu**(*bisedime zyrtare, intervista, debate, anketa, bisedime për tema të caktuara*); **Ilojet e veçanta të bisedimeve** (*fjalim solem, fjalim rasti, dolli, fjalim përshëndetës*)

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

TË LEXUARIT

Qëllimi themelor i aftësisë **së Të lexuarit** është që t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve për qasje analitike dhe sintetike në tekstet ose veprat e dhëna; dallimi i teksteve: për nevoja individuale (udhëzime, letra, biografi); për përdorim publik (rregullore, ligje); për nevoja arsimore (tekste shkollore, leksikone, enciklopedi, fjalorë etj).

Forma e provimit: pjesë me shkrim e provimit të maturës

Mënyra e realizimit: eksterne

LETËRSIA

Qëllimi themelor i aftësisë **Letërsi** është t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve për interpretimin e një vepre të caktuar letrare; të krahasojnë vepra nga lloje të ndryshme të letërsive kombëtare; të dallojnë karakteristikat e drejtimeve të caktuara letrare etj.

Forma e provimit: pjesë me shkrim e provimit të maturës

Mënyra e realizimit: eksterne

Të shkruarit

Qëllimi themelor i aftësisë **së Të shkruarit** është t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve në lëmin e të shprehurit me shkrim për tema dhe forma të ndryshme; hartimi i konceptit; mbajtja e shënimeve.

Forma e provimit: pjesë me shkrim e provimit të maturës

Mënyra e realizimit: eksterne

KRITERET PËR VLERËSIMIN E AFTËSISË TË SHKRUARIT

- Kandidati e humb të drejtën që të vlerësohet sipas kriterëve të parapara për aftësinë e Të shkruarit në qoftë se përmbajtja e teksteve nuk përputhet me temën e dhënë.
- Kandidati e humb të drejtën që të vlerësohet sipas kriterëve të parapara për aftësinë e Të shkruarit në qoftë se teksti i shkruar për qëllim praktik nuk e përmbush formën e duhur.
- Kandidati e humb të drejtën që të vlerësohet sipas kriterëve të parapara për aftësinë e të Të shkruarit në qoftë se teksti i shkruar ka më shumë ose më pakë fjalë se numri i fjalëve të dhëna në Udhëzimin për vlerësim në vitin konkret.

Kriteret për vlerësim	Indikatorët e kriterëve	Detyra e vlerësuesit
1. Gjuhë - gjithsej 4 pikë drejtëshkrim – 1 shenjat e pikësimit - 1 sintaksë -1 leksikë - 1	1. Drejtëshkrimi: - përdorimi i shkronjës së vogël dhe të madhe; - të shkruarit e fjalëve bashkë dhe ndaras; - bartja e fjalëve; 2. Shenjat e pikësimit - përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit 3. Sintaksa - kompozimi i drejtë sintaksor i fjalisë dhe përdorimi funksional i saj 4. Leksika - leksik të pasur dhe stil adekuat gjuhësor	Vlerësuesi duhet me vëmendje: - t'i zbuloj dhe klasifikoj gabimet në tekst sipas sqarimit të dhënë - ta caktojë peshën dhe përsëritjen e gabimeve (përsëritje – vazhdimisht përsëriten gabime të njejta psh: idea në vend ideja); gabimi i përsëritur numrohet njëherë - ta vlerësojë kompozicionin e drejtë sintaksor të fjalisë (rradhitjen e drejtë të fjalëve në fjali, përdorimin e lidhëzave adekuate; rradhitjen e drejtë të fjalëve në fjalinë e zgjeruar). - leksikë e pasur domethënë: përdorimi i fjalëve të ndryshme, frazave, internacionalizmave dhe përdorimi i tyre adekuat.
2. Kompozicioni i tekstit - Gjithsej 4 pikë	Në tekst qartë ndahen: - hyrja - pjesa kryesore - përfundimi 2 pikë - rregullimi i paragrafeve me fjali lidhore 1 pikë - respektimi i kufirit të numrit të paraparë të fjalëve 1 pikë	Vlerësuesi duhet me vëmendje: - ta vërtetojë prezencën e të tri pjesëve të kompozicionit; - ta vlerësojë lidhshmërinë dhe domethënien e pjesëve - ta vlerësojë rregullimin e paragrafeve të tekstit me vlerësim për prezencën e fjalive lidhore; - ta vërtetojë se a është përdorur numri i lejuar i fjalëve.
3. Përmbajtja - Gjithsej 5 pikë	Në tekst lexohet: - zhvillimi i temave me ide, argumente, fakte 2 pikë - mendimi kritik i shprehur qartë, që kanë të bëjnë me temën 1 pikë - kuptimi i plotë i temës me krijim të tekstit i cili përputhet me kërkesat e parashtruara 2 pikë	Vlerësuesi duhet me vëmendje: - ta vlerësojë kuptimin e temës dhe zhvillimin e saj në tekst. - ta vlerësojë përmbajtjen e pjesëve të kompozicionit; - ti vlerësojë faktet, idetë, pyetjet dhe përgjigjet e prezentuara në tekstin e dhënë.